Sherife Hoxha
Audituese Ligjore,Licenca Nr 338
Adresa:Rr"Islam Alla",Pall 51,kati I 1-re,zyra 9, Tirane
email hoxha.sherife@yahoo.com Cel 067 260 9703

KQZ
U PROTOKOLLUA
NR 4114 PROT
DATE 21.05.19

Tiranë, më 21.05.2019

Lënda: Relacion për misionin e auditimit për Partinë "Demokratike të Bashkimit Mysliman të Shqipërisë"

Për: Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve
Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri

Bashkëngjitur keni praktikën e misionit të auditimit për Partinë Politike "Demokratike te Bashkimit Mysliman të Shqipërisë"

Audituesi Ligjor(Ekspert Kontabël i Regjistruar)

Sherife Hoxha

Ekspert Kontabël i Regjistruar
Sherife Hoxha
Certifikata Nr.338 Tirane

Tiranë, më 21.05.2019

**Lënda: Informacion për mosrealizimin e kontratës së auditimit për Partinë "Demokratike te Bashkimit Mysliman te Shqiperise".(PP.D.B.M.SH)**

**Për: Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve**
**Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri**

Të nderuar zotërinj,

Me vendimin Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ) nr.112, datë 27.03.2019, jemi caktuar me cilesine e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përftuara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2018 per Partine " Demokratike te Bashkimit Mysliman te Shqiperise".

Menjeherë pas lidhjes së kontratës me KQZ-në, me nr prot 1315/1 datë 23.04.2019, kërkuam të vendosim komunikimin zyrtar me partinë politike "Demokratike te Bashkimit Mysliman te Shqiperise", për fillimin e procedurave të auditimit, nëpërmjet dërgimit të letrave rekomande, në adresën e selisë së partisë siç ishte përshkruar në dokumentin e dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë drejtuar KQZ-së dhe në adresat që na dërgoi KQZ-ja në vazhdim.

Por kjo mënyrë komunikimi rezultoi pa sukses, pasi letrat e dërguara rekomande u kthyen nga shërbimi postar me shpjegimin "adresë e pasaktë".
Për këtë parti u përdorën gjithashtu dhe komunikimet që mundëm të kishim me ekspertët paraardhës në misione të ngjashme, si numra telefoni apo e-maile, por dhe kjo mënyrë nuk solli rezultat.

Ne besojmë se kemi bërë përpjekjet e duhura për të vendosur komunikimin zyrtar me kryetarin dhe personat e tjerë pergjegjes në parti por kjo qe e pamundur dhe për rrjedhim misioni i auditimit për Partinë "Demokratike te Bashkimit Mysliman te Shqiperise", nuk u realizua.

Bashkangjitur dokumentacioni vertetues: Letra e dërguar dhe zarfi rekomande i kthyer nga shërbimi postar.

Faleminderit për mirkuptimin!

**Audituesi Ligjor(Ekspert Kontabël i Regjistruar)**

(firma)

Sherife HOXHA

29 APR 2019

Nr: 1094 29/04/2019

**DEFTESE**
**PRANIMI E OBJEKTEVE**

| | | |
|---|---|---|
| Objekti | Letra | Leter |
| KOD-BAR | RR848380582AA | |
| Derguesi | SHERIFE HOXHA | |
| Marresi | OSMAN MEMA KR PARTISE DEMOK BASHKIMIT MYS | |
| Vend Mberritja | , TIRANA | |
| Pesha | 10 gr | |

**Tarifa total**

Nenshkrimi: Merjola O


Hoxha
se Ligjore,Licenca Nr 338
Rr"Islam Alla",Pall 51,kati i 1-re,zyra 9 Tirane
xha sherife@yahoo.com Cel 067 260 9703


**Tiranë, më 27.04.2019**

**Kërkesë për dokumentacionin dhe fillimin e procedurave të auditimit ligjor.**

**Kryetarit te Partise Demokratike te Bashkimit Mysliman te Shqiperise z. Osman**

**e selisë: Rr"H. Cenoymeri" Pallati nr 51, shkalla 2, Ap 7,Tirane**

limin Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ) nr.112, datë 27.03.2019, jemi caktuar me e ekspertit kontabël te rregjistruar (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të dhe të shpenzuara nga Partia Demokratike e Bashkimit Mysliman te Shqiperise për endarik 2018, të deklaruara në raportin financiar vjetor dhe në raportime të tjera e dorëzuar KQZ-së për këtë periudhë.

ntratës me nr prot 1315/1 date 23.04.2019, me Komisjonin Qendror te Zgjedhjeve , objekti i misionit të auditimit eshtë: *"Kryerja e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2018, nga partitë politike në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, aktet nënligjore të KQZ-së të miratuara për këtë qëllim, ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar, dhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", se dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre"*. Afati i përfundimit të procesit te auditimit eshte 22 Maj 2019.

Per kryerjem me sukses te misionit, brenda kohes se percaktuar në kontrate, ne presim bashkëpunim tuaj dhe të personelit qe merret me sherbimin kontabel për te na bere të disponueshëm dokumentacionin kontabel,rregjistrimet dhe informacione të tjera që do të kërkohen në lidhje me auditimin tonë.

Dokumentacioni qe duhet te vihet ne dispozicon;

- Kontrata e qerase te selise se partise per vitin kalendarik 2018
- Burimet flanciare te fondeve te perfituara gjate vitit 2018 (si Llogarite bankare ,rregjistrin e posacem te dhuruesve me shumat dhe identifikimin e tyre,)
- Shpenzimet e realizuara dhe dokumentat origjinale mbeshtetese sipas legjislacionit.
- Rregjistrat Kontabel financiare te vitit 2018 dhe pasqyrat e raportimit financiar ne KQZ dhe instituconet e tjera
- Dokumenta te tjera qe ju i cmoni te nevojshme per auditimin e pasqyrave financiare te vitit 2018.

Ju lutem konfirmoni marrjen e kerkeses dhe na krijoni mundësinë e një takimi në seline e partisë tuaj sa me shpejt të jetë e mundur, për të përcaktuar termat e angazhimit të auditimit.

Presim pergjigjjen tuaj, (ne adresen ne krye te shkreses)

**Audituesi Ligjor (Eksport Kontabël i Regjistruar)**

**Sherife Hoxha**

EKSPERTE KONTABEL I REGJISTRUAR Sherife Hoxha Certifikata Nr.338 Tirane

Nerife Hoxha
Rr. Islam Alla, Pall. 51, Kati 1-rë, Zyra 9
TIRANE




29 APR

Lëvere adrese jo e biznese

RR 848 380 582 AA

Kryetarit Partisë Demokratike të Bashkimit Myslimanë të Shqipërisë
Z. Osman Mema

Rr. "H. Qerrymeri", Pall. 51, Shkalla 2, Ap. 7

TIRANE